

GJYKATAT DHE VIKTIMAT E ABUZIMIT SEKSUAL

Paketa e Avokimit të të mbijetuarve për përmirësimin e përgjigjes së drejtësisë penale ndaj të rinjve viktime të dhunës seksuale në Shqipëri

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	2
GJETJET KRYESORE	2
METODOLOGJIA E HARTIMIT DHE TË DHËNAT E KAMPIONEVE.....	3
GJETJET NË DETAJE	6
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	27
ANEKSE.....	28

HYRJE

Ky raport është përgatitur nga Paneli Këshillimor i Të Mbijetuarve të dhunës seksuale, këtu e më poshtë referuar si “Paneli” në periudhën Qershor – Shtator 2024, në kuadrin e projektit “Paketa e Avokimit të të mbijetuarve për përmirësimin e përgjigjes së drejtësisë penale ndaj të rinjve viktime të dhunës seksuale në Shqipëri”. Ky raport përbledh gjetjet e monitorimit të 5 vendimeve gjyqësore për raste të dhunës seksuale.

Aktivitete të tjera të Panelit të cilat u zhvilluan paralelisht me këtë raport ishin zhvillimi i sesioneve të informimit me të rinjtë, fushata online të ndërgjegjësimit, forumet e diskutimit me komunitetin dhe takimet me punonjës të policisë.

Për hartimin e këtij raporti, Paneli përdori eksperiencën e krijuar gjatë studimit “Gjetjet tona flasin vetë” dhe u mbështet nga stafi i ndihmës ligjore falas i të Ndryshëm & Të Barabartë. Monitorimi u trajtua nga Organizata dhe vetë Paneli si një proces i zgjerimit të njohurive të Panelit sidomos për legjislacionin dhe rolet e institucioneve të ndryshme.

GJETJET KRYESORE

Veprat penale të cilave u referohen më shpesh për abuzimin seksual janë ato të përshkruara nga tre nene të Kodit Penal: Nenit 100 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, Nenit 102, “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”, Nenit 106, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari;¹

Jo në çdo rast kur abuzuesi kishte lidhje familjare/ gjaku me viktimën është referuar tek Neni 106, “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”.

Kodi Penal ende nuk përdor termin “abuzimit seksual” por e përshkruan atë si marrëdhënie seksuale;

Ka mungesë referimi të ligji për mbrojtjen e fëmijëve në rastet kur viktime është fëmijë;

Vendimet reflektojnë një qëndrim neglizhues qytetar dhe institucional ndaj raportimit të abuzimit seksual ndaj raportimit të abuzimit seksual, më shumë si një detyrim të viktimës dhe familjarëve;

Vendimet reflektojnë progresin e bërë në trajtimin e fëmijëve, sidomos në lidhje me procedurat e aplikuar. Vendimet reflektojnë gjithashtu nevojën për përmirësimin dhe standartizimin e ekzaminimeve mjeko-ligjore dhe psikologjike;

Përcaktimi i trupës gjyqësore bëhet me short si për veprat e tjera pa marrë në konsideratë gjininë e viktimës.

¹ <https://qbz.gov.al/previeë/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d>

Të pandehurit për veprat penale të lidhura me abuzimin mund të bëjnë kërkesë për gjykim të shkurtuar njësoj si të pandehurit për vepra të tjera. Dënimet e dhëna në këto raste janë të ulëta.

Edhe të pandehurve edhe viktimave u është ofruar ndihmë juridike falas. Kjo ka bërë të mundur ushtrimin e të drejtave të tyre. Të drejta ende të neglizhuara janë e drejta për dëmshpërblim.

Dënimet e dhëna nga gjykata janë ato të kërkuara nga prokuroria. Ka megjithatë, edhe pse rrallë, ndryshime mes atyre që kërkon prokuroria dhe atyre që kërkon viktimat.

Edhe pse ka ngjashmëri mes rasteve ka ndryshime në llojet e provave të sjella. Aktet e ekspertimit mjeko - ligjor dhe ato të ekspertimit psikologjik janë të ndryshme nga njëri - tjetri në gjuhë, në format dhe në pozicionim të ekspertit karshi viktimës.

Qëndrimet e familjarëve ndaj viktimës së abuzimit nuk janë objekt i gjykatës.

Gjykata i është referuar vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

METODOLOGJIA E HARTIMIT DHE TË DHËNAT E KAMPIONEVE

Procesi i monitorimit të vendimeve të gjykatave dhe hartimit të këtij Raporti përfshiu: a) krijimin e instrumentit të monitorimit të vendimeve; b) përzgjedhjen e vendimeve për monitorim dhe anonimizimin e vendimeve; c) monitorimin/diskutimin e vendimeve ; d) shkrimin e raportit.

➤ **Krijimi i instrumentit të monitorimit të vendimeve**

Për krijimin e instrumentit të monitorimit të vendimeve fillimisht anëtarët e Panelit u njohën me strukturën standarde të një vendimi gjyqësor, terminologjinë e përdorur në vendime, dhe parashikimet bazë ligjore lidhur me organizimin dhe rolet në proceset gjyqësore për veprat e abuzimit seksual dhe veprave të tjera të lidhura me të. Në këtë fazë, stafi i ndihmës ligjore falas i Të Ndryshëm & Të Barabartë iu përgjigj pyetjeve konkrete të anëtarëve të Panelit lidhur me informacionin që pritet të përmbajë një vendim gjyqësor, informoi referencat ligjore të përmbajtjes së një vendimi², shpjegoi përshkrimet e veprave penale të abuzimit dhe ato të lidhura e abuzimin³ dhe anonimizoi një vendim gjyqësor për të lehtësuar të kuptuarin. Stafi hartoi dhe ndau me anëtarët e Panelit një draft të parë të instrumentit të monitorimit i cili u modifikua nga vetë anëtarët

² Sidomos Nenin 383 të Kodit të Procedurës Penale “Elementet e Vendimit “

³ Duke u ndalur sidomos tek Neni 100 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, Neni 101”Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç”, Neni 102”Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”, Neni 102/a”Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur”, Neni 103”Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur”, Neni 104 ”Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës”, Neni 105 “ Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën”, Neni 106 ” Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”, Neni 107 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike”, Neni 107/a “Dhuna seksuale”, Neni 108 “Vepra të turpshme”, Neni 108/a “Ngacmimi seksual”. Në Aneksë të Raportit janë vendosur për parashikimet në detaje

e Panelit.⁴ synimi ishte që instrumenti të kombinonte perspektivën e një profesionisti të ligjit me perspektivën e të mbijetuarve të abuzimit seksual duke i bërë gjetjet të kuptueshme për të dy audienat.

➤ **Përzgjedhja e vendimeve për monitorim dhe përgatitja për monitorim**

Përzgjedhja e vendimeve për monitorim u bë nga Staf i ndihmës ligjore falas i të Ndryshëm & Të Barabartë mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga Paneli. Kriteret e përzgjedhjes së vendimeve ishin:

1. njohja e rastit nga “Të Ndryshëm & Të Barabartë”- rasti të ishte ndihmuar nga Të Ndryshëm & Të Barabartë;
2. variabiliteti i njohjes së abuzuesit me viktimën – të përfshiheshin edhe raste kur abuzuesi ishte i/e njohur më parë me viktimën, edhe raste kur abuzuesi kishte qenë i/e panjohur për viktimën;
3. variabiliteti i lidhjes familjare/gjaku të abuzuesit me viktimën të përfshiheshin edhe raste kur abuzuesi kishte lidhje familjare me viktimën, edhe raste kur abuzuesi nuk kishte lidhje familjare me viktimën;
4. variabiliteti i moshës së viktimës në momentin e abuzimit – të përfshiheshin edhe vendime në të cilat viktima kishte qenë nën 18 vjeç edhe vendime në të cilat viktima kishte qenë nën 25 vjeç në kohën e abuzimit;
5. variabiliteti i distancës së kohës së raportimit dhe gjykimit nga koha e abuzimit – të përfshiheshin edhe vendime në të cilat raportimi dhe gjykimi ishte bërë në kohën e abuzimit edhe vendime për abuzime të ndodhura kohë më parë dhe të paraportuara;
6. variabiliteti i gjinisë së viktimës – të përfshiheshin vendime në të cilat viktimat ishin edhe meshkuj edhe femra;
7. variabiliteti i gjinisë së abuzuesit – të përfshiheshin vendime në të cilat abuzuesit ishin edhe meshkuj edhe femra;
8. vendimet të ishin për vepra penale të abuzimit seksual ose të lidhura me abuzimin seksual;
9. vendimet të pasqyronin realitetin aktual dhe jo të shkuarën – vendimet e shkallës së parë t’i përkisnin kohëve të fundit, reflektonin realitetin e proceseve dhe vendimeve gjyqësore;
10. vendimet të ishin të gjitha të të njëjtës shkallë të gjykimit;

Duke përdorur këto kritere, stafi i ndihmës ligjore falas i Të Ndryshëm & Të Barabartë mundi të përzgjidhte dhe të ofronte për monitorim 5 vendime gjyqësore me karakteristika si në tabelën më poshtë:

Kriteri	Variablet	Variablet	Variablet	Variablet	Variablet
---------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------

⁴ Instrumenti është këtu bashkëngjitur në pjesën “Aneksë” të Raportit

Njohja nga organizata	Njohur nga Organizata	Panjohur nga Organizata			
	5	0			
Njohja e abuzuesit me viktimën	Abuzuesi ishte i/e njohur për viktimën	Abuzuesi ishte i/e panjohur për viktimën			
	4	1			
Lidhja familjare e abuzuesit me viktimën	Abuzuesi ka lidhje familjare/gjaku me viktimën	Abuzuesi nuk ka lidhje familjare/gjaku me viktimën			
	3 ⁵	2			
Mosha e Viktimës në kohën abuzimit	Nën 18 vjeç	18-25 vjeç	Mbi 25 vjeç		
	4	1	1		
Koha raportimit	Pranë/gjatë abuzimit	Në distancë kohore pas abuzimit			
	4	1			
Gjinia viktimës	Mashkull	Femër			
	1 ⁶	5			
Gjinia abuzuesit	Mashkull	Femër			
	5				
Koha e Vendimit	1 2020	2 2019	3 2024	4 2021	5 2023
Veprat Penale të Abuzimit Seksual	100 Para. 1 ⁷	100 Para. 2 ⁸	102 Para. 1 ⁹	106 ¹⁰	100 Para 1&106
	1	2	1	2	1

⁵ Në të tre rastet abuzuesi është i ati i viktimës.

⁶ Në vendimin 1 viktimë është një djalë dhe një vajzë.

⁷ Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur, që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

⁸ Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me dhunë, ose kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.

⁹ Kryerja emarrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

¹⁰ Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësimit, dënohet me burgim gjer në shtatë vjet.

Siç mund të vihet re, vendimet e përzgjedhura plotësonin kriteret e vendosura me përjashtim të kriterit të gjinisë së abuzuesit. Nuk u arrit të gjendej një vendim për abuzues djalë/ burrë.

➤ **Monitorimi**

Monitorimi i vendimeve u zhvillua nëpërmjet nxjerrjes nga ana e stafit të ndihmës ligjore falas të Të Ndryshëm dhe Të Barabartë të materialit me interes për Panelin dhe diskutimit dhe interpretimit të materialit nga Paneli. Kjo lloj metodë u përdor për të mbrojtur të dhënat e individëve që kanë qenë apo mund të jenë ende duke u ndihmuar nga organizata. Procesi zgjati dy muaj – gjatë Gushtit dhe Shtatorit. Gjatë procesit u pa e nevojshme që instrumenti i monitorimit të përpunohej e të përmirësohej më shumë. Procesi i njohjes me materialin e vendimeve dhe i diskutimit shërbeu njëkohësisht edhe si një proces mësimi për anëtarët e Panelit, sidomos për legjislacionin dhe rolet e institucioneve të ndryshme në raport me gjykatën dhe prokurorinë,

➤ **Shkrimi i raportit**

Shkrimi i Raportit konsistoi në organizimin e informacionit të diskutimeve dhe konkluzioneve të Panelit. Gjatë shkrimit të Raportit Paneli vazhdoi të kërkonte prej stafit të Të Ndryshëm & Të Barabartë më shumë detaje nga vendimet. Rrjedhimisht edhe procesi i shkrimit të Raportit shërbeu si një proces eksplorimi dhe të mësuarit për Panelin.

GJETJET NË DETAJE

➤ **Referencat/ baza ligjore për vendimet**

Paneli vuri re se:

- Veprat penale për të cilat janë marrë vendimet e monitoruara janë ato të përshkruara në tre Nenet e Kodit Penal: Neni 100 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, Neni 102, “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”, Neni 106, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari;¹¹
- Për situata të ngjashme të moshës së viktimës dhe lidhjes familjare mes abuzuesit dhe viktimës nga Gjykata dhe Prokurori të ndryshme janë përdorur referenca të ndryshme ligjore. Jo në çdo rast kur abuzuesi kishte lidhje familjare/ gjaku me viktimën është referuar tek Neni 106, “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”. Në Vendimin Nr. V, Paneli gjeti se edhe pse abuzuesi është i ati i viktimës, Prokuroria dhe Gjykata nuk i janë referuar këtij Neni. Kjo me arsyetimin se vepra penale e përshkruar në paragrafin 2 të Neni 100¹² është më e rëndë dhe përthith edhe Nenin 106;

¹¹ <https://qbz.gov.al/previeë/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d>

¹² Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me dhunë, ose kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.

- Paneli diskutoi se lënia jashtë e referencës tek Neni 106, përjashton një rrethanë thelbësore të rëndë - që është pikërisht i afërmi që ia ka shkaktuar dëmin fëmijës. Paneli diskutoi që nëse kjo është një praktikë e zakonshme e Gjykatës dhe e Prokurorisë, atëherë kjo nuk duhet lënë në diskrecionin/ dorën e prokurorëve dhe gjykatësve, por duhet ndryshuar vetë Neni 100 që të ketë si rrethanë rënduese kryerjen e krimit nga i afërmi, babai, nëna vëllai, motra dhe dënimin në rastin kur abuzuesi të miturit/të miturës është prindi, familjari, duhet të jetë më i rëndë;
- Paneli diskutoi që në Kodin Penal duhet përdorur termi “abuzim seksual” jo thjesht “marrëdhënie seksuale” në reflektim dhe njësim me terminologjinë e përdorur në ligjin e mbrojtjes së fëmijës¹³ dhe Kodit të Procedurës Penale¹⁴

➤ Inicimi /Fillimi i çështjes penale

Mënyrat e iniciimit të çështjeve për vendime të ndryshme janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Vendimi 1	Vendimi 2	Vendimi 3	Vendimi 4	Vendimi 5
Informacione Policore	Kallzim i Viktimës (së rritur)	Kallzim i Viktimës në polici (së rritur)	Ankim i Viktimës në Polici (së rritur)	Kallzim i Viktimës (së mitur)

Paneli vuri re se ndërsa në Kodin e Procedurës Penale dhe në ligjin për mbrojtjen e fëmijëve ka disa parashikime për iniciimin,¹⁵ mënyrat më të zakonshme të gjetura në vendimet e monitoruara janë kallzimi dhe ankimi nga viktimia.

Paneli diskutoi që kufizimi i mënyrave të iniciimit vetëm tek kallzimi apo ankimi i viktimës është tregues i:

- ✓ Moskryerjes së detyrimit për kallëzim nga ana e nëpunësve publikë, personelit mjekësor, shtetasve;
- ✓ Qëndrimit ndaj raportimit të abuzimit jo si një e drejtë por si një detyrim i viktimës. Përdorimi i termit “kallëzim i viktimës” për “ankim i viktimës” konsiderohet nga Paneli si tregues i këtij qëndrimi;
- ✓ Mungesës së referimit në ligjin për mbrojtjen e fëmijëve për iniciimin në rastet kur viktimia është fëmijë;

¹³ P.sh. Neni 26 “Mbrojtja nga trafikimi dhe çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual”, Neni 62 Mbrojtja e fëmijës të abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe të dhunuar.

¹⁴ Termi abuzim seksual është përdorur në nenin 58/b

¹⁵ Në Kodin e Procedurës Penale: Neni 280 Marrja dëni për veprën penale, Neni 281 Kallëzimi nga nëpunësit publikë, Neni 282 Kallëzimi nga personeli mjekësor, Neni 283 Kallëzimi nga ana e shtetasve , Neni 284 Ankimi; Në ligjin për mbrojtjen e fëmijëve Neni 67 Detyrimi për raportim

- ✓ Përdorimit të emërtimeve/termave të ndryshme nga ligji për mbrojtjen e fëmijëve - në ligjin për mbrojtjen e fëmijëve përdoret termi “raportim”¹⁶ për “kallzim” termi “fëmijë” për “i mitur”;

➤ Marrja e Dëshmisë së Viktimës në Polici

Tabela më poshtë paraqet se kush ka qenë prezent në marrjen e dëshmisë sipas vendimeve.

Vendimi 1	Vendimi 2	Vendimi 3	Vendimi 4	Vendimi 5
Mosha e viktimës / viktimave në momentin e marrjes së Dëshmisë				
Dy viktimat ishin fëmijë	Viktima është e rritur ¹⁷	E rritur	E rritur	Fëmijë
Marrja e Dëshmisë së viktimës në Polici (kush ishte prezent)				
Oficeri i Policisë Gjyqësore Psikolog Punonjësja për Mbrojtjen e Fëmijëve Nëna e viktimave	Oficeri i Policisë Gjyqësore	Oficere e Policisë Gjyqësore	Viktima	E mitura Psikologe Punonjëse e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve Avokate e caktuar kryesisht nga Gjykata
Ambjentet e marrjes së dëshmisë				
Ambjentet e Komisarariatit	Komisariati i Policisë	Komisariati i Policisë	Komisariati i Policisë	Ambjentet e dhomës së posaçme për intervistimin e të miturve -audio - video

Në lidhje me marrjen e dëshmisë Paneli vuri re se:

¹⁶ Neni 67 Detyrimi për raportim

¹⁷ E rritur kur ka kallzuar abuzimin e ndodhur në fëmijëri

- ✓ Informacioni lidhur me marrjen e dëshmisë reflekton respektimin e parshikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur¹⁸, ligjit të mbrojtjes së fëmijëve¹⁹ dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
- ✓ Ka progress në lidhje me ambientet e marrjes së dëshmisë nga fëmija;

➤ Trupa e gjykimit

Sipas Nenit 13 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykatat e rretheve gjyqësore gjykojnë me një gjyqtar veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 10 vjet. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Sipas Nenit 28 të Kodit të Drejtësisë Penale për Mitur “Shqyrtimi gjyqësor i rasteve me të mitur”, nëse viktimi është i mitur dhe gjykimi në gjykatat e rretheve gjyqësore dhe të apelit bëhet me trup gjykues, të paktën një gjyqtar duhet të jetë i specializuar dhe i trajnuar në drejtësinë penale për të mitur. Sipas paragrafit të dytë të këtij Neni, në gjykatat e rretheve gjyqësore, në të cilat, për shkak të numrit të gjyqtarëve nuk mund të ngrihet seksioni për të mitur, kur çështja gjykohet nga tri gjyqtarë, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë gjyqtar i specializuar dhe trajnuar në drejtësinë penale për të mitur.

Tabela më poshtë jep të dhëna të trupës së gjykimit për vendimet.

Vendimi 1	Vendimi 2	Vendimi 3	Vendimi 4	Vendimi 5
Mosha e viktimës / viktimave në momentin e gjykimit				
16 vjeç vajzë 15 vjeç djalë	26 vjeç vajzë	24 vjeç vajzë	36 vjeç vajzë	16 vjeç vajzë
Numri i gjyqtarëve				
3: 1 grua, 2 burra	3: 1 grua, 2 burra	1: Burrë	1: Grua	3: 2 gra, 1 burrë
Gjyqtar Relator				
Grua	Burrë			Grua
Dakordësia mes gjyqtarëve				
Dakord	Dakord			1 Gjyqtar kundër vendimit

¹⁸ Ligj Nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për Mitur”, Neni 32 “Personat e tjerë të specializuar në drejtësinë për të mitur”, Neni 18 “ Pjesëmarrja e detyrueshme e Psikologut”. Neni 35 “Detyrat e Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës lidhur me të miturin dëshmitar dhe viktimë”

¹⁹ Neni 62, “Mbrojtja e fëmijës të abuzuar, neglizhuar, keqtrajtuar dhe të dhunuar”

Paneli vuri re se në njërin prej vendimeve, njëri prej gjyqtarëve dhe pikërisht relatori, ka qenë kundër vendimit. Paneli diskutoi se ndërsa gjinia e oficerit të policisë gjyqësore që merr kallzimin është e rëndësishme, është e rëndësishme po ashtu që të merret parasysh gjinia e viktimës edhe në shortin për trupën gjyqësore që balanca të mos anojë nga i pandehuri.

➤ Lloji i Gjykimit

Sipas Nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, të titulluar “Kërkesa për gjykimin e shkurtuar”, kërkesa për gjykimin e shkurtuar paraqitet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm në seancë paraprake ose në seancë gjyqësore dhe nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm.

Vendimi 1	Vendimi 2	Vendimi 3	Vendimi 4	Vendimi 5
		I pandehuri dakord me akuzën	I pandehuri dakord me akuzën	
Lloji i Gjykimit				
Gjykim i zakonshëm	Lloji i Gjykimit	Gjykim i shkurtuar	Gjykim i shkurtuar	Gjykim i zakonshëm

Paneli vuri re se në dy raste gjykata e ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe të pandehurve u është ulur dënimi. Paneli diskutoi se ndërsa kjo është një e drejtë e të pandehurve, dënimet e ulëta të dhëna si pasojë e kësaj procedure zvogëlojnë peshëm e asaj që i është shkaktuar viktimës dhe e vendosin atë në rrezik.

➤ Prania e viktimës në gjykatë

Të dhëna mbi praninë e viktimës në gjykatë janë në tabelën më poshtë.

Vendimi 1	Vendimi 2	Vendimi 3	Vendimi 4	Vendimi 5
Mosha e viktimës / viktimave në momentin e gjykimit				
16 vajza 15 djali	26 vjeç	24 vjeç	36 vjeç	16 vjeç
Prania e viktimës në gjykatë				
Jo të pranishme, përfaqësuar nga avokate	Jo e pranishme, përfaqësuar nga avokate OJF	Jo e pranishme, përfaqësuar nga avokate OJF	E pranishme	Jo e pranishme Përfaqësuar nga Avokate e caktuar kryesisht nga Gjykata
Të tjerë të pranishëm për viktimën				

Punonjësja e Mbrojtjes së Fëmijëve			Avokate e viktimës nga OJF	Punonjësja e Mbrojtjes së Fëmijëve
------------------------------------	--	--	----------------------------	------------------------------------

Paneli vuri re se vetëm në një rast viktimë ka qenë e pranishme në Gjykatë. Paneli diskutoi se ndërsa ky mund të jetë një tregues i ushtrimit të së drejtës për përfaqësim, dhe mbrojtje nga ritraumatizimi, mund të jetë gjithashtu një tregues se viktimë ndjehet jo komfort në gjykatë ose i druhet asaj që mund të ndodhë në gjykatë.

➤ Garantimi i mbrojtjes së viktimës dhe të pandehurit

Parashikime për garantimin e mbrojtjes ka në Ligjin Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Në ligj Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, në nenin 29 parashikojt e drejta e fëmijës për ndihmë juridike dhe psikologjike gjatë një procesi administrativ ose gjyqësor. Edhe në Ligj Nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” ka parashikime për mbrojtjen.

Vendimi 1	Vendimi 2	Vendimi 3	Vendimi 4	Vendimi 5
Mosha e viktimës / viktimave në momentin e gjykimit				
16 vjeç (V) 15 vjeç (D)	26 vjeç	24 vjeç	36 vjeç	16 vjeç
Garantimi i mbrojtjes së viktimës				
Avokat OJF	Avokat OJF	Avokat OJF	Avokat OJF	Avokate e caktuar kryesisht nga Gjykata
Garantimi i mbrojtjes së të pandehurit				
Avokat Privat	Avokate e caktuar kryesisht nga Gjykata	Avokat i caktuar kryesisht nga Gjykata	Avokat Privat	Avokat Privat

Paneli vëren se në të gjitha rastet ka pasur mbrojtje të garantuar.

➤ Pretendimet e palëve

Vendimi 1	Vendimi 2	Vendimi 3	Vendimi 4	Vendimi 5
Pretendimet e Prokurorit				
Deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të	Deklarimin fajtor të pandehurit për veprën penale	Deklarimin fajtor të të pandehurit dhe	Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës	Deklarimin fajtor të pandehurit *****

<p>"Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur" të parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 30 (tridhjetë) vjet burgim</p>	<p>"Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur" parashikuar nga Neni 100/1 i Kodit Penal dhe bazuar ne kete dispozite, denimin e tij me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim.</p> <p>Deklarimin fajtor te pandehurit _____ per vepren penale "Marrëdhënie seksuale apo homoseksuale me persona në gjini ose kujdestari", parashikuar nga neni 106 të Kodit Penal dhe bazuar ne kete dispozite, denimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim.</p> <p>Në aplikim të nenit 55/1 dhe 55/2 të Kodit Penal, bashkimit e dënimeve me burgim për të pandehurin _____ në një dënim të vetëm përfundimtar duke e dënuarr me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim.</p>	<p>dënimin e tij me 7 vite burgim;</p> <p>2. Uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin e tij përfundimisht me 4 vite e 8 muaj burgim</p>	<p>penale</p> <p>"Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura" dhe në mbështetje të nenit 102/1 i Kodit Penal dënimin e tij me 3 vjet burgim</p> <p>2. Të aplikohet për të pandehurin neni 406 i K.Pr.Penale duke i ulur dënimin e dhënë me 1/3</p>	<p>përkryerjen e veprës penale të "Marrëdhënie seksuale apo homoseksuale me të mitur" parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësajdispozite dënimin me 25 (njëzet e pesë) vite burgim.</p>
---	---	---	---	---

Pretendimet e Viktimës	Pretendimet e Viktimës	Pretendimet e Viktimës	Pretendimet e Viktimës	Pretendimet e Viktimës
Deklarimin fajtor të të pandehurit dhe dënimin sa më të ashpër sipas ligjit	Deklarimin fajtor të të pandehurit _____ per veprat penale të parashikuara nga neni 100/1 i Kodit Penal "Marredhenie seksuale ose homoseksuale me të mitur" dhe neni 106 i Kodit Penal "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari" dhe dënimin maksimal sipas ligjit.	Deklarimin fajtor të të pandehurit dhe dënimin më të ashpër sipas ligjit	Deklarimin fajtor dhe dënimin maksimal me 10 vite heqje lirie.	Dakort me prokurorin
Pretendimet e të pandehurit	Pretendimet e të pandehurit	Pretendimet e të pandehurit	Pretendimet e të pandehurit	Pretendimet e të pandehurit
Pafajësi për të pandehurin	I pandehuri dhe mbrojtësja e tij kërkuan pafajësi.	Deklarimin të pafajshëm të të pandehurit	Pafajësi	Pafajësi të plotë për të pandehurin

Paneli vëren se në përgjithësi ka përputhje mes pretendimeve të prokurorisë dhe viktimës. Megjithatë ka diskordancë të fortë mes pretendimeve të Prokurorisë dhe viktimës në rastin e vendimit IV.

Paneli vëren se ka gjithashtu ka përputhje mes pretendimeve të prokurorit dhe vendimit të Gjykatës.

➤ Lloji i provave të përdorura

Vendimi 1	Vendimi 2	Vendimi 3	Vendimi 4	Vendimi 5
------------------	------------------	------------------	------------------	------------------

Mosha e viktimës / viktimave në momentin e marrjes së provave				
16 vjeç vajza ²⁰ 15 vjeç djali	26 vjeç	24 vjeç	36 vjeç	16 vjeç
Provat e përdorura				
Dëshmi e të miturve	Kallëzimi i Viktimës	Kallëzimi i viktimës	Kallëzimi i viktimës	Procesverbal për kallëzimin e veprës penale
Akt ekspertimi Mjeko- ligjor	Akt Ekspertimi Mjeko-ligjor	Akt ri-ekspertimi Mjeko-ligjor	Akt Ekspertimi Mjeko-ligjor	Akt ekspertimi mjeko-ligjor
Akt Vlerësimi Psikologjik	Akt Vlerësimi psikologjik			Vendim për kryerjen e ekspertimit psikologjik të miturit; Raport Vlerësimi psikologjik Akt Vlerësimi psikologjik;
	Dëshmia e motrës së viktimës			
Akt ekspertimi psikiatrik		Akt ekspertimi psikiatrik i të pandehurit		
				Procesverbal për marrjen e të dhënave nga i mituri viktimë ;

²⁰ Referuar moshës kur është kryer ekspertiza mjeko-ligjore

				Kërkesë padi për lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes;
				Procesverbal i kqyrjes së telefonit të shtetasit (i pandehuri);
				Procesverbal i kqyrjes së telefonit të shtetasit viktima;
		Deklarimet e të pandehurit		

Paneli vëren se përdoren standarde të ndryshme lidhur me llojin e provave dhe ka ndryshime të mëdha nga një rast në rastin tjetër. Një nga arsytet mund të jenë ndryshimet ligjore sidomos i Kodit të Drejtësisë për të Miturit.

Paneli është i opinionit që duhet të ketë një protokoll të posaçëm lidhur me provat i cili të jetë i njohur dhe i kuptueshëm për të gjitha palët e përfshira.

➤ Akti i ekspertimit mjeko-ligjor

Paneli vuri re se në të gjitha rastet është kryer ekspertimi mjeko-ligjor. Në përputhje me ligjin, ekspertimi është kryer nga ekspertë të Institutit të Mjekësisë Ligjore²¹

Në vendime nuk ka të dhëna lidhur me gjininë e ekspertit mjeko-ligjor.

Tabela më poshtë jep informacionin që përmbajnë vendimet lidhur me ekspertimin mjeko- ligjor

Vendimi 1

²¹ Të krijuar në vitin 2003 me Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.120, datë 27.2.2003 “Për krijimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore”

“Shtetasia²² është e defloruar dhe deflorimi është i vjetër. Në trupin e shtetasës _____ nuk vihen re dëmtime të jashtme trupore. Nisur nga të dhënat antropometrike rezulton se shtetasja _____, e ka arritur pjekurinë seksuale. Deflorimi i konstatuar në trupin e shtetasës _____ është i vjetër”.

Vendimi 2

Shtetasja²³ viktima është e defloruar dhe deflorimi është i vjetër; Nisur nga të dhënat e ekzaminimit gjinekologjik dhe të statusit lokal rezulton se shtetasja viktima të ketë kryer marrëdhënie seksuale në mënyrë permanente, por pa mundur të përcaktohet hera e fundit; Nisur nga të dhënat e ekzaminimit gjinekologjik ECHO-grafik rezulton se tek shtetasja viktima, nuk përjashtohet mundësia e kryerjes së ndonjë aborti të vogël apo të madh, të hershëm apo të vonshëm.”

Vendimi 3

Vendim për kryerjen e aktit të ekspertimit mjeko ligjor dhe me aktin mjeko-ligjor __ bazuar në ekzaminimin objektiv të shtetasës²⁴ _____, në konkluzion cilësohet se tek kjo shtetase nuk u konstatuan dëmtime të jashtme trupore, kjo shtetase është e padefloruar dhe ka arritur pjekurinë seksuale.

2.Nga ana e organit të akuzës është vendosur kryerja e riekspertimit mjeko-ligjor dhe sipas aktit të ekspertimit mjeko-ligjor nr. ____ është arritur përfundimi se: në trupin e shtetasës _____ nuk u konstatuan dëmtime të jashtme trupore, ajo ka arritur pjekurinë seksuale dhe kjo shtetase është e defloruar dhe deflorimi është i vjetër sipas konceptit mjeko-ligjor.

Vendimi 4

Tek shtetasja²⁵ __ konstatohen ekimoza poshtë syrit të majtë, ekimozë në pjesën e jashtme të kycit të dorës së majtë, ekimozë në pjesën e jashtme të kycit të dorës së djathtë. Gjithashtu në vaginën e _____ vihet re një dermishje. Dëmtimet e mësipërme janë shkaktuar me mjet të fortë mbretës, ato hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të cilat sjellin si pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën deri në 9 ditë.

Vendimi 5

“Referuar të dhënave fizike të shtetasës²⁶ _____ mendojmë se e ka arritur pjekurinë seksuale. Shtetasja _____ është e defloruar. Deflorimi është i vjetër. Në trupin e shtetasës _____ nuk u vunë re dëmtime trupore të vjetra apo dhe të freskëta.”

²² 16 vjeç në momentin e ekspertimit

²³ 26 vjeç në momentin e ekspertimit

²⁴ 24 vjeç në momentin e ekspertimit

²⁵ 36 vjeç në momentin e ekspertimit

²⁶ 16 vjeç vjeç në momentin e ekspertimit

Paneli vëren se në ekspertimin e Vendimit 2, është përdorur një gjuhë evazive , që nuk përkon me rëndësinë që i jepet kësaj lloj prove. Sipas Panelit, eksperti duhet të japë përgjigje precise dhe të përdorë terminologjinë e duhur. Në Vendimin nr.4 vihet re një shpjegim i detajuar i ekspertit të Mjekësisë Ligjore duke parashikuar të gjitha dëmtimet e viktimës dhe paaftësinë që sjell te viktima kjo veper penale. Nga krahasimi i informacionit mbi ekspertimin mjekoligjor në vendime të ndryshme, Paneli arriti në konkluzionin se është e nevojshme të përdoret një format dhe një mënyrë të shprehuri standarde për aktet e ekspertimit.

Në monitorimin e rastit / Vendimit 3 , Paneli vëren se është kryer ekspertimi mjeko-ligjor dy herë. Sipas Panelit ekspertimi është një procedurë shumë e sikletshme për viktimën dhe përsëritja e ekspertimit është psikologjikisht e dëmtuese.

Paneli vëren se ekspertimi i kushton rëndësi faktit që është arritur pjekja seksuale apo jo. Paneli vëren se ndërsa kjo mund të jetë e rëndësishme në kuptimin e nenit të zbatueshëm, pjekuria fizike seksuale është e parëndësishme në kontekstin e abuzimit seksual .

Për Panelin, është e rëndësishme që të vendoset një standard për gjininë e mjekut ligjor të ngjashëm e atë të oficerit të policisë gjyqësore.

Paneli diskutoi që edhe pse në vendime nuk ka informacion lidhur me vendin/ ambjentin e ekspertimit, mënyra e shprehjes së ekspertëve mund të konsiderohet si një tregues i kufizimit të ambjenteve dhe pajisjeve ku kryhet ekspertimi, të kapaciteteve të ekspertëve dhe si pasojë edhe sfidave që hasin gjykatat në trajtimin e kësaj lloj prove.

➤ **Ekspertimi psikologjik i viktimës**

Paneli ka qenë i interesuar të eksplorohet informacioni lidhur me ekspertimin psikologjik të viktimës si një provë e rëndësishme. Ekspertimi psikologjik është kryer nga prokuroria në tre raste²⁷

Sipas Vendimit 1, fëmijët i janë nënshtruar dy herë ekspertimit psikologjik, herën e dytë i urdhëruar nga Prokuroria pranë Gjykatës Shkallës Parë. Vendimi i Gjykatës bën të njohur problemet që ka patur vlerësimi psikologjik i parë. Sipas Gjykatës, konkluzioni i arritur nga ekspertja psikologe nuk ka përputhje me provat e administruara dhe me vlerësimin psikologjik të realizuar nga organi i akuzës. Sipas Gjykatës, *“psikologu ka dhënë mendim juridik dhe nuk ka bërë vlerësim psikologjik lidhur pasojat e abuzimit seksual”*.

²⁷ Vlerësimit psikologjik i referohet Vendimi 1, Vendimi 2 dhe Vendimi 5

Paneli vuri re se në një akt ekspertimi, ekspertja është shprehur në mënyrë evazive. Paneli konsideron se nuk mund të kuptohet nëse ekspertimet psikologjike janë bërë duke përdorur metoda shkencore.

Paneli vuri re se ndërsa Kodi i Procedurës Penale ka parashikime lidhur me aktet e ekspertimit nuk ka parashikime specifike lidhur me ekspertimin psikologjik.²⁸ Paneli konsideron se kryerja e ekspertimit pa një format të qartë dhe të kuptueshëm për të gjitha palët paraqet rrezik për viktimën dhe për vetë procesin.

Paneli vuri re gjithashtu që parashikimet ligjore lënë vend për kryrjen e vlerësimit psikologjik më shumë se një herë, dhe prej më shumë se një subjekti. Paneli konsideron se vlerësimi psikologjik i përsëritur e vë viktimën në një pozicion ritraumatizimi.

➤ Të drejtat e Viktimës

Të drejtat e viktimës janë të parashikuara në disa nene të Kodit të Procedurës Penale: Neni 9/a, Neni 58. Të drejta specifike për viktimën kur është fëmijë parashikohen nga Neni 58/a ndërsa Neni 58/b parashikon të drejtat e viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore.

Tabela më poshtë i paraqet respektimet ndaras sipas rasteve/ vendimeve.

	Vendimi 1	Vendimi 2	Vendimi 3	V 4	V5
E drejta	Mosha e viktimës / viktimave në momentin e gjykimit				
	16 vjeç (V)	26 vjeç	24 vjeç	36 vjeç	16 vjeç
	15 vjeç (D)				
	Respektimi i të drejtës				
Të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit (N.58/a i KPP)	Po	Po	Po	Po	Po
b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën	Po	Po	Po	Po	Po

²⁸ Neni 182 i KPP, “Disponimet e organit procedues”, Neni 183 “Caktimi i detyrës”, Neni 184 “Veprimet e ekspertit”, Neni 185, “Akti i ekspertimit” Neni 314 “Caktimi i ekspertit”, Neni 366, “Caktimi i ekspertimit gjatë gjykimit”

ndaj viktimave të veprës penale. (N.58/a i KPP)					
Të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar. (N.58/a i KPP)	-	-	-	Po	-
Të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi (N.58/a i KPP)	Po	Po	Po	Po	Po
Të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cënuar parimin e sekretit hetimor. (N.58/a i KPP)	Po	Po	Po	Po	Po
Të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrijë kërkesa të tjera përpara organit procedues. (N.58/a i KPP)	-	-	-	Po	-
Të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirim të tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod. (N.58/a i KPP)	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
Të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit. (N.58/a i KPP)	Po	Po	Po	Po	Po
Të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen. (N.58/a i KPP)	-	-	-	-	-
Të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal. (N.58/a i KPP) ²⁹	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
Të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale (N.58/a i KPP)	Po	Po	Po	Po	Po
Të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore. (N.58/a i KPP)	Po	Po	Po	Po	Po

²⁹ Parashikime të tjera lidhur me dëmshpërblimin në Nenin 61 të Kodit të Procedurës Penale- “Padia civile në procesin penal”, në Nenin 62 “Afati për legjitimimin e paditësit civil” dhe në Nenin 63 “Sigurimi i padisë civile”

Të dëgjohej nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar. (N.58/a i KPP)	Po	Po	Po	Po	Po
Viktima e mitur të shoqërohet nga një person i besuar prej tij (N.58/a i KPP)	Po	-	-	-	Po
Viktimës së mitur t'i ruhet konfidencialiteti i të dhënave personale. (N.58/a i KPP)	Po	-	-	-	Po
Viktima e mitur të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut. (N.58/a i KPP)	Po	-	-	-	Po
Organi procedues të trajtojë viktimën e mitur të veprës penale duke mbajtur parasysh moshën, personalitetin dhe rrethana të tjera, me qëllim shmangien e pasojave të dëmshme për zhvillimin dhe edukimin e saj të ardhshëm (N.58/a i KPP)	Po	-	-	-	Po
Nëse ekziston mundësia që viktima është e mitur dhe mosha e viktimës nuk dihet, prezumohet se ajo është e mitur. (N.58/a i KPP)	-	-	-	-	-
Viktima e mitur pyetet pa vonesë nga persona të specializuar për këtë qëllim. (N.58/a i KPP)	Po	-	-	-	Po
Kur është e mundur dhe e përshtatshme, biseda regjistrohet me mjete audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Ky regjistrim mund të përdoret si provë në procedimin penal dhe vlerësohet së bashku me provat e tjera, sipas kritereve që parashikohen nga paragrafi 4, i nenit 361/a, të këtij Kodi. (N.58/a i KPP)	Po	-	-	-	-
Kur viktima e mitur është nën 14 vjeç, biseda zhvillohet në mjedise të përshtatura për të. (N.58/a i KPP)	-	-	-	-	-
Viktima e abuzuar seksualisht dhe viktima e trafikimit të qenieve njerëzore ka të drejtë të pyetet pa vonesë nga një oficer i policisë gjyqësore ose prokuror i të njëjtës gjini (N.58/b i KPP) ³⁰	-	-	-	-	-
Viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë të drejtë të kërkojnë të dëgjohej	Po	Jo	-	-	Jo

³⁰ Neni 58/b Të drejtat e viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore

nëpërmjet mjeteve audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi. (N.58/b i KPP)					
Viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit kanë të drejtë të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me jetën private, e cila qartësisht nuk ka lidhje me veprën penale (N.58/b i KPP)	Po	Po	Po	Po	Po

Paneli vuri re se përgjithësisht vendimet reflektojnë respektim të të drejtave të viktimave para dhe gjatë procesit gjyqësor.

Paneli vuri re se ndërsa është e pritshme të ketë ndryshime nga vendimi në vendim për shkak të përmirësimit të situatës së të drejtave të viktimës që ka sjellë ndryshimi i ligjit, kemi megjithatë një mungesë të vazhdueshme të aplikimit të së drejtës për dëmshpërblim.

Të drejta të tjera më pak të respektuara janë e drejta për seancë me dyer të mbyllura - sipas Vendimit 2 dhe 3 seanca ka qenë publike; për të mos u pyetur disa herë- fëmijët në Vendimin 1 janë pyetur disa here, për të mos u pyetur në prani të pandehurit,- Viktima në Vendimin 2 është pyetur në prani të pandehurit; që pyetja të rregjistrohet me video - Viktimat e mitura në Vendimin 1 janë pyetur pa vonesë por biseda nuk është regjistruar me audio video.Vetëm gjatë gjykimit është bërë pyetja audio-video.

Paneli vëren se ndërsa është e rëndësishme që viktima të mbrohet dhe të informohet gjatë kohës së procedimit, është gjithashtu shumë e rëndësishme të informohet gjatë kohës së vuajtjes së dënimit të abuzuesit – nëse ai/ajo lirohet. Për Panelin kjo është një çështje edhe e parashikimit ligjor mbi të drejtat por edhe e praktikës gjyqësore.

➤ Qëndrimet e familjes

Paneli ka qenë i interesuar të dijë dhe analizojë vendimet lidhur me sa reflektojnë ata dijeninë dhe qëndrimet e familjarëve ndaj abuzimit dhe qëndrimet që ka mbajtur gjykata kundrejt familjarëve joabuzues. Tabela më poshtë paraqet të dhëna të nxjerra nga vendimet. Për panelin ka qenë e rëndësishme të eksplorohej nëse është kërkuar heqje e përgjegjësisë prindërore për prindin abuzues.³¹

³¹ Sipas Nenit 30 të Kodit Penal, të titulluar "Dënime plotësuese", humbja e përgjegjësisë prindërore është një nga dënimet plotësuese që mund të jepen bashkë me dënimin kryesor për personat që kanë kryer krime ose kundërvajtje penale. Sipas Nenit 43/a "Humbja e përgjegjësisë prindërore" e Kodit Penal, humbja e përgjegjësisë prindërore jepet nga gjykata ndaj personit që e ushtron përgjegjësinë prindërore, kur ai dënohet si autor ose bashkëpunëtor në një vepër penale ndaj fëmijës ose si bashkëpunëtor me fëmijën në kryerjen e një veprë penale. Sipas Nenit 223 të Kodit të Familjes, të titulluar " Humbja e përgjegjësisë prindërore" , prindërit e fëmijës mund të humbasin përgjegjësinë prindërore nëpërmjet një vendimi penal që i ka dënuar ata si autorë ose si bashkëpunëtorë për një vepër penale ndaj fëmijës së tyre, si bashkëpunëtorë në një vepër penale të kryer nga fëmija i tyre ose nëse janë dënuar për ndonjë nga shkaqet e braktisjes së familjes, për sa kohë që ata nuk kanë marrë përsipër detyrimet që kanë ndaj saj. Sipas Nenit 228 të Kodit të Familjes, të titulluar "Heqja e përgjegjësisë prindërore" kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore ose tregon

Vendimi 1	Vendimi 2	Vendimi 3	Vendimi 4	Vendimi 5
Marrëdhënia e të pandehurit me viktimat				
I pandehuri është bashkëjetues i nënës së viktimave.	I pandehuri është i ati i viktimës	I pandehuri është i ati i viktimës	I pandehuri është njohur rastësisht me viktimën	I pandehuri është i ati i viktimës
Dijenja e prindërve dhe familjarëve të tjerë				
Nëna nuk ka patur dijeni për abuzimet Ka marrë dijeni kur fëmijët janë pyetur në polici	Prindërit e viktimës kanë qenë të divorcuar dhe nëna e ka braktisur viktimën	Viktima është braktisur nga nëna dhe nuk ka kontakte me nënën. Vendimi nuk ka dhëna për dijenin e nënës	Vendimi nuk ka të dhëna	Nëna nuk ka patur dijeni për abuzimet Kur ka marrë dijeni ka denoncuar së bashku me vajzën në polici
Pyetja e prindërve dhe familjarëve të tjerë				
Nëna është pyetur në polici dhe gjykim				Nëna është pyetur në polici dhe gjykim
Qëndrimi e prindërve dhe familjarëve të tjerë				
	Motra e viktimës-mbështetëse është pyetur si dëshmitare gjykatë			Nëna ka patur qëndrim mbështetës ndaj vajzës
Heqje e përgjegjesisë prindërore				
Jo	Jo	Jo		Jo

pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, ose me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve, me kërkesën e prindit tjetër, të të afërmeve të fëmijës ose të prokurorit, mund t'i hiqet përgjegjësia prindërore. Heqja e përgjegjesisë prindërore bëhet me vendim të gjykatës, duke u thirrur si i paditur prindi, për të cilin kërkohet kjo heqje.

Paneli është i opinionit se Prokuroria duhet të hetojë dhe Gjykata të vlerësojë dijeninë dhe qëndrimet e prindërve dhe familjarëve të tjerë në raport me viktimën dhe atë që konsiderohet abuzuesi-që është marrë si i/e pandehur.

Paneli vëren se në asnjë rast nuk është hequr e drejta prindërore e abuzuesit, Paneli është i opinionit që kjo mungesë bëhet shkak për abuzime të tjera – abuzuesi mund të kërkojë që viktimën ta vizitojë në kohën e kryerjes së dënimit, të akuzojë prindin tjetër për rrëmbim fëmije etj..

➤ Afatet dhe Vendimi

Kodi i Procedurës Penale ka parashikime lidhur me afatet në Nenin 323 dhe Nenin 324. Sipas Nenit 323, “Afati i hetimeve paraprake”. Sipas këtij Neni, afati i përfundimit të hetimeve është 3 muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, dhe gjashtë muaj për veprat penale të parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 75/a, të këtij Kodi. Sipas Nenit 324 “Zgjatja e afatit”, Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj. Në rastin e Prokurorisë së Posaçme ky afat është deri në gjashtë muaj. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t’i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Tej afatit 2-vjeçar, për raste të akuzave për krim të organizuar dhe për krime që gjykohen me trup gjykues, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cenuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit. Tej afatit 2-vjeçar, në raste të jashtëzakonshme, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cenuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve jepet i arsyetuar dhe u njoftohet të pandehurit dhe viktimës dhe provat e marra pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren.

Tabela më poshtë jep të dhëna mbi afatet e aplikuara

Vendimi 1	Vendimi 2	Vendimi 3	Vendimi 4	Vendimi 5
Data e regjistrimit prokurori:				
10.2018	12.2018	08.2023	05.2021	05.2022
Data e regjistrimit gjykatë:				
03.2019	05.2019	02.2024	10.2021	03. 2023
Data e vendimit				

02.2020	12.2019	04.2024	12.2021	12.2023
---------	---------	---------	---------	---------

Paneli konsideron se çështjet marrin shumë kohë dhe kjo kohë është në dëm të shëndetit dhe sigurisë.

Paneli konsideron se dënimet e dhëna sidomos për marrëdhëniet seksuale në familje janë të ulëta. Tabela më poshtë jep të dhëna për dënimet.

Vendimi 1	Vendimi 2	Vendimi 3	Vendimi 4	Vendimi 5
Lloji i gjyqimit				
Gjykim i zakonshëm	Gjykim i zakonshëm	Gjykim i shkurtuar	Gjykim i shkurtuar	Gjykim i zakonshëm
Vendimi i gjykatës				
Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, parashikuar nga neni 100/2 i K.P. dhe dënimin e tij me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim.	Deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” dhe në bazë të nenit 100/1 i K.P., dënimin e tij me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”,	Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”, parashikuar nga neni 106 i K.P. dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vite burgim. 2. Në aplikim të nenit 406 të KPP ³² , të pandehurit, i ulët 1/3-ta e dënimit, duke u dënuar përfundimisht	Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”, parashikuar nga neni 102/1 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 3 vjet burgim.	Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale të “ Marrëdhënie seksuale apo homoseksuale me të mitur” parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin me 25 (njëzet e pesë) vite burgim

³² Kur jep vendim dënimi gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën

	<p>dhe në bazë të nenit 106 të K.P., dënimit e tij me 7 (shtatë) vjet burgim.</p> <p>Në zbatim të nenit 55 të K.Penal, në bashkim të dënimeve, e dënon të pandehurin me një dënim të vetëm prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim.</p>	me 4 (katër) vite e 8 (tetë) muaj burgim.		
Institucioni i vuajtjes së dënimit				
Vuajtja e dënimit me burgim në një burg të sigurisë së zakonshme.	Vuajtja e dënimit për të pandehurin fillon nga dita e ndalimit të tij, të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.	Ekzekutimi i këtij vendimi fillon ditën e ndalimit të të pandehurit datë 29.8.2023 dhe pjesa e mbetur e pavyajtur e dënimit, do të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.	Në aplikim të nenit 406 të KPP, të pandehurit i ulet 1/3-ta e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 2 vite burgim.	Vuajtja e dënimit me burgim do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme

➤ **Referimi në vendime të tjera**

Paneli ishte i interesuar të eksplorohej nëse Gjykata i referohej, përveç ligjeve, edhe vendimeve të gjykatave të tjera në vend apo gjykatave të tjera jashtë.

Në dy raste, në Vendimin 1 dhe Vendimin 4, Gjykata i është referuar vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Në Vendimin 1 i referohet Vendimit M.C. kundër Bullgarisë³³ ndërsa në vendimin 4 i referohet çështjes Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë.

Në rastin e Vendimit 1 referimi bëhet në lidhje me “frikën e ngrirë” – që ka lidhje me reagimin e viktimës dhe në rastin e Vendimit 4 referimi bëhet për koncepte të faktit e provave dhe prezumimit të pafajësisë – që ka lidhje me trajtimin e të pandehurit.

Në vendimin 4, Gjykata i referohet një Vendimi Unifikues të Gjykatës së Lartë.

➤ **Referimi në Ligjin për Mbrojtjen e fëmijëve dhe Kodin e Drejtësisë Penale për Mitur(KDPM)**

Paneli vuri re se Gjykata ose nuk i referohet, ose nuk i referohet korrekt parashikimeve të ligjit për mbrojtjen e fëmijëve apo Kodit të Drejtësisë Penale për Mitur (KDPM). Në Vendimin 1, edhe pse çështja është rregjistruar në Prokurori dhe ka ardhur në gjykatë pas vitit 2017 kur datojnë këto akte, Gjykata i referohet Ligjit Nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, dhe nuk i referohet fare KDPM-së. Në Vendimin 5, Gjykata nuk i referohet fare as njërit dhe as tjetrit.

➤ **Qëndrimet e Gjykatës në raport me prokurorinë**

Paneli vuri re se në të gjitha rastet Gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurve dhe dënimin me burgim aq sa e ka kërkuar Prokuroria, pra nuk ka patur qëndrime ndryshe të gjykatës me prokurorinë.

Paneli diskutoi nevojën që Gjykata të shkojë përtej asaj që kërkon prokuroria, dhe t’i ushtrojë kompetencat e veta për të zgjidhur çështje të rëndësishme siç është dëmshpërblimi dhe përgjegjësia prindërore.

➤ **Evidentimi i bashkëpunimit të Gjykatës me institucionet e tjera**

Paneli ishte i interseuar të eksploronte vendimet gjyqësore në lidhje me rolin dhe përfshirjen e institucioneve të tjera sidomos të institucioneve të pushtetit vendor në procesin e gjykimit. Nga vendimet 1 dhe 5 shihet një rol i rëndësishëm i Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijëve në proces. Një rol të rëndësishëm në proces duket se luajnë edhe avokatët e Ndihmës Ligjore Falas.

³³ file:///C:/Users/user/Downloads/CASE%20OF%20M.C.%20v.%20BULGARIA%20-%20[Albanian%20Translation]%20summary%20by%20the%20European%20Centre,%20COE%20and%20EC.pdf

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Lënia jashtë e referencës tek Neni 106, përjashton një rrethanë thelbësore të rëndë - që është pikërisht i afërmi që ia ka shkaktuar dëmin fëmijës. Është e nevojshme të ndryshohet Neni 100 që të ketë si rrethanë rënduese kryerjen e krimit nga i afërmi, babai, nëna vëllai, motra dhe dënimi në rastin kur abuzuesi të miturit/të miturës është prindi, familjari, të jetë më i rëndë.

Përdorimi i termave të ndryshme në kode dhe ligje të ndryshme shkakton konfuzion dhe minon ushtrimin e të drejtave të viktimës dhe trajtimin e saj. Rekomandohet që në ndryshimin e legjislacionit të synohet njësim i termave dhe sidomos konkordancë me legjislacionin për fëmijët.

Vendimet reflektojnë një qëndrim neglizhues qytetar dhe institucional ndaj raportimit të abuzimit seksual, më shumë si një detyrim të viktimës dhe familjarëve. Është e nevojshme të eksplorohet më tej ky qëndrim dhe të adresohen shkaqet e këtij qëndrimi.

Vendimet reflektojnë progresin e bërë në trajtimin e fëmijëve, sidomos në lidhje me procedurat e aplikuara. Është i nevojshëm përmirësimi dhe standartizimi ekzaminimeve mjeko-ligjore dhe psikologjike dhe raportimit i tyre.

Përcaktimi i trupës gjyqese me short si për veprat e tjera pa marrë në konsideratë gjininë e viktimës ia lë rastësisë përbërjen gjinore të trupës gjyqese. Është e nevojshme që krahas përgatitjes së gjyqtarëve për të trajtuar gjini të ndryshme, të gjendet një formulë që të shmangni disbalancën gjinore me viktimën.

Edhe të pandehurve edhe viktimave u është ofruar ndihmë juridike falas që ndihmon në aplikimin e të drejtave. Është e nevojshme që avokatët falas të viktimave të kenë një rol më proaktiv në kërkimin e të drejtave sidomos të drejtës për dëmshpërblim.

Ngjashmëria e dënimeve të dhëna nga gjykata me ato të kërkuara nga prokuroria e zvogëlon rolin e gjykatës në mbrojtje të viktimës. Gjykata mund dhe duhet të jetë më proaktive në vendosjen e standarteve të respektimit të të drejtave.

Vendimet reflektojnë sfidat që has gjykata në shqyrtimin ekspertimeve mjeko-ligjore dhe psikologjike. Është e nevojshme që të bëhet standartizimi i procedimit për ekspertimet dhe i dokumentimit të tyre.

Vendimet reflektojnë ndryshimet e mëdha që janë bërë në parashikimet ligjore për procedurën penale, sidomos në trajtimin e viktimave fëmijë. Është e nevojshme që këto ndryshime të bëhen të njohura për publikun e gjerë.

ANEKSE

Formular /Instrumenti i monitorimit

	Shënime
Të dhëna për viktimat e veprës penale	
Mosha e viktimës:	
Gjinia e viktimës:	
I pandehuri	
Marredhenia e të pandehurit me viktimën	
Cila është baza ligjore përkatëse që është përdorur për t'ju referuar çështjes	
Kush e inicioi ceshtjen penale?	
Marrja e dëshmisë së viktimës në Polici (kush ishte prezent)-Gjykatë	
Nr.i gjyqtareve?	
Cfarë lloj provash janë përdorur	
Rastet e gjykuara dhe procedura gjyqësore	
Lloji i gjykimit të zbatuar në rastin konkret	
Prania e viktimave gjatë gjykimit	

Sfidat	
Akti i ekspertimit psikologjik	
Referimi në vendime të tjera	
Referimi në Ligjin Për mbrojtjen e fëmijëve	
Evidentimi i bashkëpunimit të Gjykatës me institucionet e tjera	
Vendimi i gjykatës	
Ligji i aplikuar Masa e dënimit ndaj autorit Lloji i burgut	
Dëmshpërblimi i viktimës	
Statusi i çështjes	
Afati kohor i zgjatjes së këtij gjykimi	
Vlerësime	

Tiranë, 2024